

VENDIM
Nr.549, datë 29.12.1992

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË MBROJTJES SË BIMËVE

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Institutit të Mbrojtjes së Bimëve, mbi bazën e Stacionit qendror kërkimor për mbrojtjen e bimëve, me qendër në Durrës, në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, me objekt kryerjen e kërkimeve shkencore në këtë fushë, diagnostikimin, prognozë-sinjalizimin, propozimin e masave të luftimit dhe atyre karantinore kundër parazitëve të bimëve, kryerjen e provave biologjike e agronomike për regjistrimin e pesticideve dhe kontrollin cilësor të tyre.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.29, datë 9.2.1971 "Për disa masa për përmirësimin e mëtejshëm të punës kërkimore- shkencore në lëmin e prodhimit bujqësor", pika 2 "c" "Për krijimin e stacionit qendror për mbrojtjen e bimëve në Durrës" si dhe vendimi nr.152, datë 15.4.1983 "Për krijim ndërmarrjesh e institucionesh", pika 4 "Për krijimin e Stacionit qendror të kërkimeve për mbrojtjen e bimëve", shfuqizohen.

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi